



Republika e Kosovës - Republikën Kosova - Republic of Kosovo Qeveria e Kosovës - Vlada Republika - Government of Kosovo MINISTRIE TREGTISË DHE INDUSTRIE - MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE - MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	14
Nr. i ligjeve Strukturaliste No. pages	3	Data: Datum: Date:	19,01/2010
Prishtinë / a			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë*  
*Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry*

Në bazë të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 paragrafi 3.5 të Ligjit Nr.03/I-138 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.2004/5 Për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 01/2010**

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SË LICENCIMIT  
NË SEKTORIN E NAFTËS**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ rregullon organizimin dhe funksionimin e Zyrës së licencimit për rregullimin dhe vëzhgimin e sektorit të naftës në Kosovë (në tekstin e mëtejme Zyra). Zyra vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

**Neni 2**  
**Organizimi dhe Funksionimi i Zyrës së licencimit**

1. Zyra udhëhiqet nga Drejtori i cili i përgjigjet Ministrit të MTI-së, menaxhon me zyrën dhe bënë organizimin e brendshëm në pajtim:

- 1.1. Me organogramin e MTI-së;
- 1.2. Me planin e punës dhe zhvillimit;
- 1.3. Planin vjetor të financimit.

2. Struktura organizative, numri i pozitave, përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësiive përcaktohet në kuadër të organogramit të MTI-së.

### **Neni 3**

1. Zyra është përgjegjëse për rregullimin dhe vëzhgimin e sektorit të naftës në Kosovë.
2. Në kryerjen e detyrave Zyra u përmbahet parimeve të neutralitetit, objektivitetit, pavarësisë dhe profesionalizmit.

### **Neni 4** **Detyrat e Zyrës**

Detyrat e Zyrës janë të përcaktuara në Ligjin për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë.

### **Neni 5** **Procedura për shqyrtimin e kërkesës për dhënien e licencës**

1. Drejtori i zyrës cakton grupin për shqyrtimin e kërkesave të parashtruara për licencim.
2. Grupi përbëhet prej zyrtarëve nga zyra dhe ka për detyrë:
  - 2.1. Të verifikoj materialin dhe në rast të mangësive në dokumentacion të kërkoj nga subjektet që të plotësojnë dokumentacionin;
  - 2.2. Të shqyrtoj anën formale të kërkesës;
  - 2.3. Si dhe punë të tjera të përcaktuara me vendim me rastin e formimit të komisionit.
3. Grupi pas çdo shqyrtimi i raporton me shkrim drejtorit.

### **Neni 6**

1. Drejtori, pas shqyrtimit të raportit merr vendim për:
  - 1.1. Dhënien e licencës;
  - 1.2. Ripërtëritjen e licencës-vazhdimin;
  - 1.3. Refuzimin e kërkesës për dhënien e licencës.
2. Drejtori mund të marr pjesë në mbledhjet e grupit.

### **Neni 7** **Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi shfuqizohet udhëzimi administrativ nr. 2005/16 Krijimi i Këshillit për Rregullimin dhe Vëzhgimin e Sektorit të Naftës në Kosovë.

**Neni 8**  
**Dispozitat kalimtare**

Zbatimin dhe mbikëqyrjen e punës së Zyrës së Licencimit e bënë Ministri i MTI- së.

**Neni 9**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë.

Prishtinë, 19. 01. 2010

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë  
Lutfi Zharku

